



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**VENDIM**

**PËR MIRATIMIN E LISTAVE SHUMEMËRORE TË KANDIDATËVE PËR ANËTARË NË KËSHILLIN E BASHKIVE TË DEPOZITUARA NGA PARTIA "FRYMA E RE DEMOKRATIKE", PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË VITIT 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 22.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Për pranimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtarë në Këshillin e Bashkive: Tiranë, Korçë, Elbasan, Durrës, Fier, Kamëz Vlorë, të paraqitura nga Partia Fryma e Re Demokratike, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

**BAZË LIGJORE:** Neni 23, pika 1, germa "a", dhe neni 73, pika 1, të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Partia Fryma e Re Demokratike, si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

**V Ë R E N:**

Partia Fryma e Re Demokratike, me vendimin e KQZ-së nr. 202, datë 23.04.2019, është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019.

Në bazë të nenit 67, dhe nenit 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", ka depozituar në KQZ listën shumemërore të kandidatëve të saj për anëtarë në Këshillin e Bashkive: Tiranë, Korçë, Elbasan, Durrës, Fier, Kamëz Vlorë.



**Nr. 634 i Vendimit**

**Data 22.05.2019**

**Ora 17:00 e Vendimit**

Për miratimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkive të paraqitura nga Partia "Fryma e Re Demokratike" për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

Në bazë të nenit 67, pika 3, KQZ duhet të regjistrojë kandidatët për kryetar apo për Këshillin e Bashkive; Tiranë, Korçë, Elbasan, Durrës, Fier, Kamëz Vlorë; pasi bashkitë: Tiranë, Korçë, Elbasan, Durrës, Fier, Kamëz Vlorë administrohen nga më shumë se një KZAZ.

KQZ, ka vendosur kthimin për plotësim të listës shumemërore të kandidatëve për këshillin e bashkive:

- Fier me vendimin nr. 500, datë 17.05.2019.
- Vlorë me vendimin nr. 469, datë 17.05.2019.
- Kamëz me vendimin nr. 496 datë 17.05.2019.

Brenda afatit Partia Fryma e Re Demokratike, nuk ka plotësuar dokumentacionin sipas vendimit të KQZ-së për Bashkinë Fier, Vlorë dhe Kamëz. Në këto kushte KQZ referuar nenit 73, pika 2 duhet të refuzojë listat e kandidatëve për Këshillin e Bashkisë Fier, Vlorë dhe Kamëz të Partisë Fryma e Re Demokratike.

Në bazë të nenit 67, pika 3, KQZ duhet të regjistrojë kandidatët për kryetarë apo për këshillin e bashkive: Tiranë, Korçë, Elbasan, Durrës; pasi bashkitë Tiranë, Korçë, Elbasan, Durrës administrohen nga më shumë se një KZAZ.

Bashkëlidhur kërkesës është depozituar dhe dokumentacioni përkatës, si më poshtë:

1. Listat shumemërore të kandidatëve për anëtarë në Këshillin e Bashkive Tiranë, Korçë, Elbasan, Durrës;
2. Deklaratat e kandidatëve të listave shumemërore, të cilët deklarojnë se gëzojnë të drejtën dhe vullnetin për të kandiduar për anëtarë këshilli në Këshillin e Bashkive: Tiranë, Korçë, Elbasan, Durrës, të propozuar nga Partia Fryma e Re Demokratike;
3. Kopje të dokumentit të identifikimit për të gjithë kandidatët e listave shumemërore;
4. Vërtetim i Këshillit Bashkiak, Tiranë, Korçë, Elbasan, Durrës sipas të cilës vërtetohet se zotërojnë mandate në Këshillit Bashkiak të Bashkisë Tiranë, Korçë, Elbasan, Durrës ;
5. Jetëshkrimin për të gjithë kandidatët e listës shumemërore;
6. Formularin e vetëdeklarimit, në zbatim të ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike";
7. Procesverbal i dorëzimit të dokumentave të kandidimit;

Në mbledhjen e datës 22.05.2019 në bazë të nenit 73, të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikoi listat shumemërore të kandidatëve për këshillin e Bashkive Tiranë, Korçë, Elbasan, Durrës, të Partisë Fryma e Re Demokratike dhe dokumentacionin bashkëngjitur të paraqitur dhe konstatoi se është në përputhje me kërkesat e parashikuara nga neni 67, pika 2, 4, 5 dhe 6 dhe neni 72 të Kodit Zgjedhor.

Në zbatim të ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", verifikoi të dhënat në formularët e vetëdeklarimit për secilin kandidat të listës shumemërore. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, asnjëri prej tyre nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe zyra e gjendjes civile nëpërmjet shkresave si dhe nëpërmjet postës elektronike për kandidatët për



**Nr. 634 i Vendimit**

**Data 22.05.2019**

**Ora 17:00 e Vendimit**

Për miratimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkive të paraqitura nga Partia "Fryma e Re Demokratike" për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

anëtarë në këshillat bashkiak, që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, nga ku rezulton se: Tiranë, Korçë, Elbasan, Durrës:

#### **Lista shumemërore e Bashkisë Tiranë:**

1. Kandidati me numër **rendor 37, z. Andi Bardhok Doda** në bazë të vendimit nr. 273, dt.03.02.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është deklaruar fajtor për veprën penale të "Drejtim automjeti në mënyrë të parregullt" të parashikuar nga neni 291 K.P dhe neni 406 te K.Pr.P është dënuar me 1 muaj burgim. Në aplikim të neni 63 të K.P ka kryer punë me interes publik për 40 orë punë.  
Rehabilituar në bazë te neni 69 te Kodit Penal.
2. Kandidati me numër **rendor 54, znj. Bianka Nexhip Sheqeri** në bazë të vendimit nr. 259, dt.10.05.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është deklaruar fajtor për veprën penale të "Kontrabandës me mallra të tjerë" të parashikuar nga neni 174 K.P dhe neni 406 te K.Pr.P është dënuar me 80 000 lekë gjobë.  
Rehabilituar në bazë te neni 69 te Kodit Penal.

#### **Lista shumemërore e Bashkisë Durrës:**

1. Kandidati me numër **rendor 7, znj. Alma Stefan Marku** në bazë të vendimit nr. 210, dt.07.04.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është deklaruar fajtor për veprën penale të "Lidhjes së paligjshme të energjisë elektrike" të parashikuar nga neni 137/1 të Kodit Penal është dënuar me 100 000 lekë gjobë.  
Rehabilituar në bazë te neni 69 te Kodit Penal.

#### **Lista shumemërore e Bashkisë Elbasan:**

1. Kandidati me numër **rendor 34, znj. Dashmira Rrahim Malja** në bazë të vendimit nr. 169, dt.24.11.1972 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan është deklaruar fajtor për veprën penale "Plagosje e lehtë me dashje" të parashikuar nga neni 149/1 të Kodit Penal është dënuar me 4 muaj punë korrektuese dhe me ndalimin e 1/5 të rrogës.  
Rehabilituar në bazë te neni 69 te Kodit Penal.
2. Kandidati me numër **rendor 41, z. Abaz Estref Kovaçi** në bazë të vendimit nr. 338, dt.21.10.1980 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan është deklaruar fajtor për veprën penale të "Rrahjes " të parashikuar nga neni 177/1 të K.P është dënuar me 6 muaj riedukim nëpërmjet punës dhe me ndalimin e 1/5 të rrogës. Deklaruar fajtor për fyerje dhe në bazë të neni 185/1 të K.P është dënuar me 4 muaj riedukim nëpërmjet punës dhe me 1/5 e rrogës mujore. Në bazë të neni 55 të K.P është dënuar me 6 muaj riedukim nëpërmjet punës dhe me 1/5 e rrogës mujore.  
Rehabilituar në bazë të neni 69 te Kodit Penal.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar pikës 2, paragrafi i fundit, të kreut V të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, konstaton se për personat e shënuar në listën shumemërore të dhënat e tyre nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin si kandidatit për këshillin e bashkisë, sipas ligjit nr. 138/2015. KQZ gjithashtu ka bërë publikimin e formularëve të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.



**Nr. 634 i Vendimit**

**Data 22.05.2019**

**Ora 17:00 e Vendimit**

Për miratimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkive të paraqitura nga Partia "Fryma e Re Demokratike" për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

## **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 23, pika 1, germa "a", nenin 67, pikat 2, 4, 5, dhe 6, nenin 72, dhe nenin 73, pika 1 të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

## **V E N D O S I:**

1. Miratimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtarë në Këshillin e Bashkive: Tiranë, Korçë, Elbasan, Durrës të Partisë Fryma e Re Demokratike, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Refuzimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtarë në Këshillin e Bashkisë Fier, Vlorë dhe Kamëz të Partisë Fryma e Re Demokratike në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv/Kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI-</b>	<b>Anëtare</b>



**Nr. 634 i Vendimit**

**Data 22.05.2019**

**Ora 17:00 e Vendimit**

Për miratimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkive të paraqitura nga Partia "Fryma e Re Demokratike" për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019